



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Call-Home Electronics" Sh.P.K. të datës 10.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Sistemet inteligjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Call-Home Electronics" Sh.P.K. e datës 10.07.2023 kundër kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Sistemet inteligjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 10.07.2023 i autoritetit kontraktues për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Call-Home Electronics" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Call-Home Electronics" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 10.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Sistemet inteligjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "*Arsyetim i AK për vendimin e Anulimit të aktivitetit të prokurimit: Ju nuk keni dorëzuar Certifikatën e biznesit sipas kërkesës të Autoriteti kontraktues: Ne ushtrimin e veprimtarive nuk figurojnë veprimtaria e shërbimit të sistemeve të sigurisë siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë. Andaj për këtë aktivitet jeni i përgjegjshëm. Ne si O.E. i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit kemi dorëzuar Kopjen e certifikatës së biznesit ashtu siq është kërkuar në DT. Kompania jonë operon që nga themelimi në vitin 2011 me punë të ngjashme dhe se aktiviteti kryesor i kompanisë është Instalime elektrike e gjithashtu edhe shume aktivitete tjera të veprimtarisë sonë janë të lidhura me punë të ngjashme. Sistemet e sigurisë dhe sistemet telegjente të cilat aplikohen janë sisteme që realizohen vetëm përmes instalimeve elektrike por me një avansim në këtë fushë për të cilën ne vetëm se jemi kompania e cila i aplikon në shumë projekte këto instalime. Gjithashtu "VEPRIMTARIA E SISTEMEVE TË SIGURISË" të cilën edhe ne jemi të interesuar ta shtojmë si emërtim në listën e veprimtarive tona ende nuk gjendet në listën zyrtare sipas kodeve për aktivitete në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë - ARBK".*

Fillimisht duhet cekur se sipas dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit është kërkuar: "*1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë së sistemeve të sigurisë-numri unik Identifikues të regjistrimit". Dëshmia e kërkuar për këtë kriter ka qenë "1.Kopja e Certifikatës së biznesit".*

Lidhur me pjesën e pretendimit ku parashtruesi konfirmon se "e ka dorëzuar certifikatën e biznesit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit prandaj nuk qëndron arsyetimi i autoritetit kontraktues për eliminim për shkak të mungesës së këtij dokumenti", zyrtari përgjegjës i prokurimit me rastin e administrimit të dokumenteve në ofertën e parashtruesit ka gjetur se aty evidentohet edhe certifikata e biznesit të parashtruesit me numër unik identifikues 810812413. Në anën tjetër është gjetur se në raportin e komisionit të vlerësimit si arsye për eliminimin e parashtruesit është evidentuar pikërisht mungesa e certifikatës së biznesit të parashtruesit. Ky konstatim i komisionit vlerësues nuk është i saktë prandaj është gjetur se kjo pjesë e pretendimit të parashtruesit është i bazuar.

Sa i përket pjesës së pretendimit të parashtruesit ku thuhet se "*veprimtaria e sistemeve të sigurisë ende nuk gjendet në listën zyrtare sipas kodeve për aktivitete në ARBK*", duhet cekur se parashtruesi ka pasur mundësi që të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim ndaj kërkesave të dosjes së tenderit me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë. Megjithatë parashtruesi asnjëherë nuk është pajtuar me kërkesat e dosjes së tenderit që nënkupton se i njëjti është pajtuar në tërësi me dosjen e tenderit me rastin e paraqitjes së ofertës së tij për këtë aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente mjaftueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij. Prandaj është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.07.2023



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.